



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 08.03.2023

Nr: 119

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA UNITETI KOMBËTAR”, PËR REGJISTRIMIN
SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ
2023

Sot më datë, 8.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1107 Prot, datë 24.02.2023, me:

Kërkues: Partia politike “Partia Uniteti Kombëtar”, me kryetar z. Idajet Beqiri.

Objekti: Regjistrimi i partisë politike “Partia Uniteti Kombëtar” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Baza ligjore: Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

“Partia Uniteti Kombëtar”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Idajet Beqiri, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023, administruar.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

Data: 8.3. 2023 Nr: 119
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Uniteti Kombëtar”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 20.01.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Uniteti Kombëtar”, me iniciale “PUK”, me kryetar z. Idajet Beqiri, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Uniteti Kombëtar”, me shkronja nistore “PUK”, me adresë Kutia Postare 8288, ose Rruga “Nikolla Jorga”, Pll.3,Shk.3, Ap.2, Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla 2, Kati 2, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Idajet Beqiri, me adresë Kutia Postare 8288, ose Rr “Nikolla Jorga”, Pll.3,Shk.3, Ap.2, Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla 2, Kati 2, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është zj. Grejida Muça, me adresë Kutia Postare 8288, ose Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla nr.10, Ap.17, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Idajet Beqiri, me adresë Kutia Postare 8288 ose Rruga “Nikolla Jorga”, Pll.3, Shk.3, Ap.2, Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla 2, Kati 2, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Uniteti Kombëtar”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga “Partia Uniteti Kombëtar”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64 pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të udhëzimit nr. 1, datë 18.1.2023, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

VENDOSA:

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Uniteti Kombëtar”, me kryetar z. Idajet Beqiri, me shkronjat nistore “PUK”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

